

**LIGJI Nr. 04/L-31
PËR BASHKËPUNIM JURIDIK NDËRKOMBËTAR NË ÇËSHTJET PENALE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR BASHKËPUNIM JURIDIK NDËRKOMBËTAR NË ÇËSHTJET PENALE

**KREU I
DISPOZITAT THEMELORE**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike ndërkombëtare në çështjet penale, në qoftë se me marrëveshjen ndërkombëtare nuk është caktuar ndryshe apo nëse nuk ekziston marrëveshja ndërkombëtare.
2. Në mungesë të një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe shtetit të huaj ndihma juridike ndërkombëtare mund të ofrohet mbi bazën e parimit të reciprocitetit.
3. Procedurat gjyqësore të ofrimit të ndihmës juridike ndërkombëtare rregullohen me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, përveç nëse ndryshe është paraparë me këtë ligj.

**Neni 2
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Ndihma juridike ndërkombëtare në çështjet penale** - të gjitha llojet e ndihmës me qëllim të mbështetjes së procedurave hetimore dhe gjyqësore të paraqitura në formë të lutjes nga një shtet tjetër ose që kanë origjinë nga Kosova.
 - 1.2. **Lutja** - akti me të cilën kërkohet ndihma juridike ndërkombëtare.
 - 1.3. **Shtet lutës** - shtetin që ka paraqitur lutje për ndihmë juridike ndërkombëtare.
 - 1.4. **Shteti i lutur**- shteti i huaj të cilës i dërgohet lutja për ndihmë juridike ndërkombëtare.
 - 1.5. **Ministria** - Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës.
 - 1.6. **Organi Kompetent për çështje të drejtësisë** - departamenti për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.
 - 1.7. **Organ gjyqësor vendor** - gjykatat dhe prokurorit të cilat me ligj janë caktuar për dhënien e ndihmës juridike ndërkombëtare.

1.8. **Organ gjyqësor i huaj** - organi kompetent i shtetit të huaj që ofron ose kërkon ndihmë juridike ndërkombëtare.

1.9. **Ligj vendor** - Legjislacioni i Kosovës.

1.10. **Urdhër-kërkim ndërkombëtar** – lajmërim i publikuar nga Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale-INTERPOL që kërkon arrestimin e përkohshëm të personit të kërkuar me qëllim të ekstradimit duke u bazuar në ndonjë urdhër arrest apo vendim tjetër gjyqësor;

1.11. **Vendim gjyqësor** - aktgjykim, aktvendim, vendim apo ndonjë urdhër gjyqësor që shqiptohet nga organi gjyqësor;

1.12. **Dënim** - çdo sanksion të shqiptuar nga organi gjyqësor;

1.13. **Sanksion** - çdo masë e shqiptuar ndaj personit, lidhur me një vepër penale përmes aktgjykimit;

1.14. **Shteti dënues** - shteti në të cilin dënimi është shqiptuar ndaj personit i cili mund apo është transferuar;

1.15. **Shteti zbatues** - shteti tek i cili personi i dënuar mund ose është transferuar më qëllim të mbajtjes së dënimit të shqiptuar ndaj tij.

1.16. **Ekstradimi** - për qëllim të këtij ligji nënkupton edhe dorëzimin e përkohshëm.

Neni 3

Mënyra e Komunikimit dhe gjuha

1. Lutjet për ndihmë juridike ndërkombëtare do të përcillen nga organi i huaj gjyqësor përmes Ministrisë në organin gjyqësor të vendit dhe anasjelltas.

2. Në rastin kur lutja është pranuar drejtpërdrejt apo nga Interpoli në formë elektronike ose në ndonjë mënyrë tjetër të komunikimit, organi gjyqësor vendor do të ofrojë ndihmë, me kusht që shteti kërkues garanton që brenda 18 (tetëmbëdhjetë) ditësh do të dërgohet lutja dhe dokumentet origjinale, përmes rrugëve të rregullta.

3. Nëse lutja dhe dokumentet e bashkangjitura janë në gjuhë të huaj, ato duhet të kenë të bashkangjitur përkthimet e vërtetuara në gjuhën Shqipe dhe Serbe. Përkthimet e vërtetuara në gjuhë Angleze mund të pranohen në bazë të reciprocitetit.

KREU II

LUTJET E PËRGJITHSHME PËR EKSTRADIM

Neni 4

Parimet e përgjithshme

1. Personi mund të ekstradohet me qëllim të ndjekjes penale apo ekzekutimit të dënimit.

2. Shtetasit e Kosovës nuk do të ekstradohen, përveç nëse është paraparë ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe shtetit kërkues, ose me të drejtën ndërkombëtare.

Neni 5

Dorëzimi i përkohshëm

Në bazë të Marrëveshjes Ndërkombëtare, i pandehuri mund të dorëzohet përkohësisht tek shteti i huaj me kusht që pas seancës dëgjimore para gjykatës të kthehet në Kosovë në mënyrë që të mbaj dënimin me burg ose vazhdimin e masës së paraburgimit të dhënë kundër tij ose saj.

Neni 6 **Vendi i kryerjes së veprës penale**

1. Ekstradimi nuk do të lejohet për veprat penale të kryera në tërësi në territorin e Republikës së Kosovës dhe mund të mos lejohet për vepra penale të kryera pjesërisht në territorin e Republikës së Kosovës.

2. Nëse vepra penale është kryer kundër një shtetasi të Kosovës jashtë territorit të Kosovës, ekstradimi lejohet me kusht që autoritet gjyqësore vendore nuk i fillojnë ose i përfundojnë procedurat penale në lidhje me të njëjtën vepër penale.

Neni 7 **Parashikimi i veprës penale**

Ekstradimi do të lejohet vetëm për veprat penale të dënueshme sipas ligjit vendor dhe ligjit të shtetit lutës.

Neni 8 **Veprat penale për të cilat lejohet ekstradimi**

1. Ekstradimi do të lejohet vetëm për veprat penale të dënueshme me heqje të lirisë për një periudhë së paku një (1) vit ose me dënim më të rëndë sipas ligjit vendor dhe shtetit të lutur.

2. Kur ekstradimi është kërkuar për ekzekutimin e dënimit, ekstradimi lejohet nëse kohëzgjatja e dënimit ose pjesa e mbetur e dënimit tejkalon periudhën prej gjashtë (6) muajsh burgim.

3. Nëse lutja për ekstradim përfshinë disa vepra penale të veçanta, ku secila prej tyre është e dënueshme me burgim në bazë të ligjit vendor dhe të shtetit lutës, por disa prej tyre nuk përmbushin kushtet në lidhje me masën e dënimit që mund të jepet, ekstradimi për këto vepra penale mund të lejohet.

Neni 9 **Parashkrimi**

Ekstradimi i personit të kërkuar nuk lejohet kur sipas legjislacionit vendor dhe të shtetit kërkues është bërë parashkrimi i ndjekjes penale ose ekzekutimit të dënimit.

Neni 10 **Dyshim i bazuar**

Ekstradimi lejohet kur ekzistojnë prova të mjaftueshme sipas të cilave ekziston dyshimi i bazuar që personi ka kryer veprën penale për të cilën ekstradimi është kërkuar ose nëse ka ndonjë aktgjykim të ekzekutueshëm.

Neni 11 **Ne bis in idem**

Ekstradimi nuk lejohet në rast se, organet kompetente në Kosovë apo në një shtet të tretë kanë shpallur aktgjykim të formës së prerë kundër kryerësit të veprës apo veprave penale për të cilat është kërkuar ekstradimi. Lutja për ekstradim mund të refuzohet nëse autoritetet gjyqësore vendore kanë vendosë ose të mos fillojnë apo të përfundojnë procedurat në lidhje me të njëjta vepra penale.

Neni 12

Vepra penale politike

1. Ekstradimi nuk do të lejohet nëse vepra penale për të cilën është paraqitur lutja është vepër penale politike ose vepër që është e ndërlidhur me vepër penale politike.

2. Për qëllim të këtij ligji, vepra penale politike nuk përfshin:

2.1. privimin nga jeta apo tentativa për privim nga jeta e Kryetarit të shtetit, ose një anëtar të familjes së tij/saj;

2.2. vrasja;

2.3. shkaktimi i lëndimit të rëndë trupor;

2.4. rrëmbimi, dhunimi, marrja e pengjeve, shantazhi ose detyrimi;

2.5. shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm;

2.6. tentativa për veprat penale nga nënparagrafët 2.1 – 2.5 të këtij paragrafi, dhe

2.7. bashkëpunimi për t'u përfshirë në shtrëngim, shtytje, apo ndihmë personit tjetër lidhur me ndonjë nga veprat penale nga nën-paragrafët 2.1 – 2.5 të këtij paragrafi.

3. Paragrafi një (1) i këtij neni nuk do të zbatohet për veprat penale të gjenocidit, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe terrorizmit.

Neni 13

Vepra penale ushtarake

Ekstradimi nuk lejohet për veprën penale e cila hyn në kuadër të veprave penale ushtarake, dhe e cila nuk paraqet vepër penale edhe sipas ligjit penal.

Neni 14

Dënimi me vdekje

Ekstradimi nuk lejohet për vepër penale të dënueshme me dënim me vdekje sipas ligjit të shtetit lutës, përveç nëse shteti lutës jep garanci të mjaftueshme se dënimi me vdekje nuk do të zbatohet apo ekzekutohet.

Neni 15

Tortura, trajtimi çnjerëzor, degradues ose keqtrajtimi

Ekstradimi nuk lejohet nëse ka dyshim të bazuar se personi i ekstraduar do të trajtohet ose ndëshkohet në mënyrë çnjerëzore ose degraduese.

Neni 16

Klauzola diskriminuese dhe standardet e të drejtave të njeriut

1. Ekstradimi nuk lejohet nëse ka dyshim të bazuar se lutja për ekstradim është bërë me qëllim të ndjekjes ose ndëshkimit të personit për shkak të racës, fesë, gjinisë, shtetësisë, bindjes politike,

përkatësisë etnike ose anëtarësisë në ndonjë grup shoqëror ose që pozita e personit në shoqëri mund të paragjykohet për një nga këto arsye.

2. Ekstradimi nuk do të lejohet nëse personi nuk do të pranojë garancinë minimale për një gjykim të drejtë nga shteti lutës.

3. Ekstradimi i kërkuar me qëllim të ekzekutimit të dënimit refuzohet, nëse Aktgjykimi është shqiptuar në mungesë, nëse personi i dënuar nuk është njoftuar me kohë për gjykimin apo për mundësinë për të angazhuar mbrojtës dhe nëse i njëjti nuk ka pasur apo nuk do të ketë mundësinë për rigjykim, përveç nëse shteti lutës ofron garanci, i cili konsiderohet i mjaftueshëm, se do ti garantoj atij personi të drejtën në ri-gjykim duke i mundësuar të drejtën në mbrojtje, apo përveç nëse personi edhe pse është njoftuar me kohë dhe ka pasur mundësinë të paraqitet dhe të angazhoj mbrojtës, ka vendosur të mos veprojë.

4. Ekstradimi nuk lejohet nëse ka dyshime se personi mund të gjykohet ose dënohet në shtetin lutës nga një Gjykatë e jashtëzakonshme ose e përkohshme, përveç nëse autoritetet kompetente të shtetit lutës garantojnë se gjykimi do të bëhet nga gjykata e rregullt në pajtim me ligjin.

5. Ekstradimi nuk lejohet për çfarëdo arsye të bazuar që është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare ose me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut.

KREU III EKSTRADIMI NGA KOSOVA TEK SHTETI I HUAJ

Neni 17 Lutja për ekstradim

1. Procedura për ekstradimin e personit do të iniciohet vetëm mbi bazën e lutjes me shkrim drejtuar Ministrisë.

2. Lutja për ekstradim do të paraqet veprat penale për të cilat kërkohet ekstradimi dhe do ti bashkëngjiten dokumentet e mëposhtme:

2.1. përshkrimi sa më i saktë i personit të kërkuar, së bashku me të dhëna të tjera që do të ndihmonin në vërtetimin e identitetit të personit, shtetësinë dhe vendndodhjen;

2.2. origjinalin apo kopjen e vërtetuar të urdhër arrestit lëshuar nga organet kompetente të shtetit kërkuar, ose nëse personi i kërkuar është dënuar për ndonjë vepër, Aktgjykimin origjinal apo kopjen e vërtetuar ose ndonjë shkresë tjetër që përcakton dënimin e shqiptuar, faktin që dënimi është i ekzekutueshëm dhe kohëzgjatjen e mbetur të dënimit që të mbaj. Këto dokumente duhet të përmbajnë kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, roli në kryerjen e veprës penale, kualifikimi ligjor. Në rastet e caktuara dokumentet që nuk përmbajnë të dhënat sipas këtij paragrafi, duhet të shoqërohen me një deklaratë në të cilën përshkruhen të dhënat lidhur me veprën penale;

2.3. ekstrakti nga ligji penal relevant i shtetit, lidhur me çështjen në fjalë;

2.4 nëse personi i kërkuar është dënuar për ndonjë vepër penale në mungesën e tij, do të bashkëngjitet deklarata me të cilën tregon se personi është ftuar personalisht, ose është njoftuar me datën dhe vendin e mbajtjes së seancës dëgjimore që ka sjell deri tek vendimi, ose duke specifikuar mjetet ligjore në dispozicion për personin që të përgatitet për mbrojtjen e tij ose të ketë çështjen në rigjykim me prezencën e tij.

3. Nëse pas shqyrtimit të lutjes, të dhënat dhe shkresat e kërkuara si në paragrafin 2. të këtij neni janë të pa mjaftueshme, Ministria do të kërkojë nga shteti lutës të plotësoj lutjen.

Neni 18

Roli i Prokurorisë së Qarkut

1. Pas shqyrtimit të kërkesës për ekstradim, Ministria do të dërgoj lutjen, së bashku me dokumentet mbështetëse tek Zyra e Prokurorit të Qarkut në territorin e të cilit personi i kërkuar aktualisht banon ose në territorin e të cilit ai ose ajo gjendet. Nëse vendbanimi i personit është i panjohur, lutja do të dërgohet tek Zyra e Prokurorit të Qarkut në Prishtinë.
2. Prokurori i Qarkut menjëherë ndërmerr veprime për identifikimin dhe përcaktimin e vendndodhjes së personit të kërkuar dhe më pas do të parashtroj kërkesën për ekstradim tek Gjykata Kompetente e Qarkut.
3. Prokurori i Qarkut mund të kërkoj nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake që personit të kërkuar ti caktoj paraburgimin sipas Kodit të Procedurës Penale.
4. Policia do të arrestoj personin nëse ka arsye për caktimin e masës së paraburgimit sipas Kodit të Procedurës Penale.

Neni 19

Seanca e procedurës paraprake mbi caktimin e masës së paraburgimit

1. Personi do të ftohet ose do të sjellët pa ndonjë vonesë para gjyqtarit të procedurës paraprake të gjykatës kompetente për seancën paraprake, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale. Marrja në pyetje dhe dhënia e deklaratës së personit do të regjistrohet në procesverbal.
2. Gjyqtari i procedurës paraprake do të urdhëroj lirimin e menjëhershëm të personit nëse vërteton se:
 - 2.1. personi është shtetas Kosovar dhe gjithashtu nuk ka ndonjë obligim ndërkombëtar që të ekstradohet, dhe se në kohën e shqyrtimit, Ministria e Drejtësisë në një të ardhme të afërt nuk ka qëllim që të ketë marrëveshje ndërkombëtare në lidhje me këtë çështje me shtetin lutës;
 - 2.2. personi nuk është i njëjti i identifikuar në kërkesën për ekstradim ose në ndonjërin prej dokumenteve si në nenin 17 paragrafin 2. të këtij ligji;
 - 2.3. urdhër arresti apo dokumenti që ka sjellë deri tek arrestimi i personit është anuluar.
3. Nëse caktohet masa e paraburgimit, Gjyqtari i procedurës paraprake do të caktoj masën e paraburgimit prej tridhjetë (30) ditësh. Gjyqtari do të vendos sipas detyrës zyrtare për vazhdimin e paraburgimit çdo tridhjetë (30) ditë ose urdhëron paraburgimin deri në përfundimin e procedurës së ekstradimit, ku i pandehuri ka të drejtë që të ankohet për paraburgimin brenda afatit prej shtatëdhjetë (72) orëve nga marrja e vendimit. Nëse gjyqtari i procedurës paraprake urdhëron paraburgimin e personit, Ministria duhet të informohet.
4. Vendimi mbi masën e paraburgimit mund të ankimohet.

Neni 20

Arrestimi i përkohshëm

1. Në bazë të lutjes për arrestim të përkohshëm, para pranimit të lutjes për ekstradim, personit të kërkuar do ti caktohet masa e paraburgimit për një periudhë prej dyzet (40) ditësh, në pritje të lutjes për ekstradim. Lutja për arrestim të përkohshëm mund të pranohet edhe me anë të mjeteve elektronike të komunikimit.
2. Lutja për arrestim të përkohshëm do të theksojë se dokumentet e përcaktuara në nenin 17 paragrafin 2. të këtij ligji ekzistojnë dhe se ka për qëllim paraqitjen e lutjes për ekstradim. Po ashtu do të përmbajë veprën penale për të cilën do të kërkohet ekstradimi si dhe kur dhe ku është kryer vepra penale, dhe do të përmbajë atë që është e mundur përshkrimin e personit të kërkuar.

3. Urdhër kërkime ndërkombëtare të shpërndara nga Interpol do të kenë fuqinë e njëjtë me kërkesën për arrest të përkohshëm.

4. Bazuar në lutjen për arrestim të përkohshëm, Prokurori i Qarkut dhe policia do të kenë të drejtë të arrestojnë personin e kërkuar. Masa e paraburgimit duhet të konfirmohet nga gjyqtari i procedurës paraprake i gjykatës kompetente të qarkut brenda dyzetetë (48) orëve nga arrestimi i tij, duke marrë në konsideratë dispozitat nga neni 19 paragrafin 2. të këtij ligji.

5. Personi i arrestuar do të informohet lidhur me arsyen e arrestimit të tij dhe të pranojë kopjen e urdhër arrestit sa më shpejtë të jetë e mundur.

6. Gjyqtari i Procedurës Paraprake sipas detyrës zyrtare do të lirojë personin nëse lutja për ekstradimin e tij nuk është pranuar nga Ministria brenda dyzet (40) ditësh prej ditës së arrestimit të tij.

7. Personi i arrestuar mund të parashtroj ankesë brenda afatit prej shtatëdhjetedy (72) orëve kundër vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake dhënë në bazë të paragrafit 4. të këtij neni. Mundësia për lirimin e përkohshëm në çdo kohë nuk është e përjashtuar, por gjyqtari i procedurës paraprake duhet të ndërmarr masat që i konsideron të nevojshme për të parandaluar arratisjen e personit të kërkuar. Lirimi nuk do të përjashtoj mundësinë e arrestimit të serishëm të tij dhe ekstradimin nëse lutja për ekstradim është pranuar më pas.

Neni 21

Procedura gjyqësore për ekstradim

1. Lutja për ekstradim do të shqyrtohet nga kolegji prej tre gjyqtarësh të Gjykatës Kompetente të Qarkut.

2. Gjykata pa vonesë do të mbajë seancën, me prezencën e prokurorit, personit të kërkuar dhe mbrojtësit të tij. Nëse i pandehuri nuk ka mbrojtës, gjykata do të ja caktoj sipas detyrës zyrtare.

3. Gjykata do të marr në pyetje personin në lidhje me rrethanat personale dhe veçanërisht në lidhje me shtetësinë e tij. Gjykata do ta këshilloj të njëjtin që është i lirë që të deklarohej apo mos të deklarohej rreth akuzave të ngritura kundër tij në shtetin lutës, Gjykata do të pyes të njëjtin nëse kundërshton ekstradimin e tij dhe nëse po, mbi çfarë baze.

4. Gjykata do të vendos lidhur me çdo kundërshtim të paraqitur nga personi për të cilin kërkohet ekstradimi dhe mbi lejueshmërinë e lutjes për ekstradim.

5. Nëse i pandehuri nuk ngritë asnjë kundërshtim rreth ekstradimit të tij, Gjykata do ta këshilloj atë në lidhje me mundësinë e ekstradimit të thjeshtësuar dhe pasojave ligjore.

6. Nëse Gjykata gjen se informatat e dërguara nga shteti kërkues nuk janë të mjaftueshme që të marrë vendim, Gjykata mund të parashtroj kërkesë për informata plotësuese tek Ministria e cila do ta përcjellë tek shteti lutës. Gjykata mund të përcaktoj afat kohor për pranimin e informatave të tilla.

7. Gjykata mund të vlerësoj çdo provë tjetër që e konsideron si të nevojshme.

8. Nëse është duke u zhvilluar ndonjë procedurë tjetër penale në Kosovë kundër personit nga ajo që është kërkuar ekstradimi, gjykata do ta evidentojë në procesverbal dhe do ta njoftoj Ministrinë. Gjykata do të garantoj që çdo kërkesë pronësore e parashtruar nga pala e dëmtuar është siguruar.

Neni 22

Dorëzimi i sendeve në procedurën e ekstradimit

1. Në lutjen e shtetit kërkues, në përputhje me ligjin vendor, gjykata kompetente do konfiskoj dhe dorëzoj sendet që do të mund të përdoren si provë ose që janë fituar si rezultat i veprës penale.

2. Sendet e parapara në paragrafin 1. të këtij neni do të dorëzohen në shtetin lutës edhe nëse lutja për ekstradim është lejuar, por ekstradimi nuk është realizuar si pasojë e vdekjes ose arratisjes së personit të kërkuar.

3. Nëse sendet dhe materialet e parapara në paragrafin 1. të këtij neni i nënshtrohen sekuestrimit ose konfiskimit në Kosovë, në lidhje me ndonjë procedurë penale që është në procedurë e sipër, ato mund të mbahen ose dorëzohen me kusht që të rikthehen në Kosovë.

4. Sendet dhe materialet e parapara në paragrafin 1. të këtij neni mbi të cilat Kosova ka të drejtë, do të rikthehen në Kosovë sa më shpejtë që është e mundur pas përfundimit të procedurës gjyqësore në shtetin e huaj. Shpenzimet lidhur me kthimin e sendeve do të mbulojnë nga shteti lutës.

Neni 23

Refuzimi i kërkesës për ekstradim

1. Nëse kolegji prej tre gjyqtarëve të gjykatës kompetente të qarkut gjen se kushtet për ekstradim nuk janë përmbushur, ajo nxjerr vendim me të cilën refuzon kërkesën për ekstradim.

2. Prokurori i Qarkut mund të parashtrojë ankesë kundër vendimit.

3. Nëse personi gjendet në paraburgim, kolegji prej tre gjyqtarësh mund të vendos që personi të mbetet në paraburgim deri sa vendimi për refuzimin e kërkesës për ekstradim bëhet i formës së prerë.

4. Vendimi i formës së prerë me të cilën ekstradimi është refuzuar do të përcjellët në Ministri, e cila do ta informoj shtetin lutës.

Neni 24

Vendimi për lejimin e ekstradimit në procedurë gjyqësore

1. Nëse kolegji prej tre gjyqtarësh të gjykatës së qarkut gjen se kushtet për ekstradim janë plotësuar, ajo nxjerr vendim për lejimin e ekstradimit.

2. Kundër Vendimit për ekstradim, pala ka të drejtë ankese në Gjykatën Supreme.

Neni 25

Procedurat Ankimore

Nëse Gjykata Supreme pas shqyrtimit të ankesës konstaton që kushtet për ekstradimin e personit janë përmbushur çështja do të dërgohet tek ministri i Drejtësisë i cili do të vendos për ekstradimin.

Neni 26

Vendimi për lejimin e ekstradimit

Ministri do të lëshoj vendim, nëse ekstradimi është lejuar apo refuzuar. Ministri mund të vendos që ekstradimi i personit të kërkuar të shtyhet për arsye të procedurës tjetër penale që është duke u zhvilluar para gjykatës vendore kundër personit të kërkuar ose për arsye se personi është duke vuajtur dënimin në Kosovë.

Neni 27

Kushtet për ekstradim

1. Vendimi i Ministrit me të cilin lejon ekstradimin do të përcaktojë kushtet e mëposhtme:

1.1. personi nuk mund të ndiqet penalisht ose të dënohet për veprë tjetër penale të kryer para ekstradimit dhe për të cilën veprë ekstradimi nuk është lejuar;

1.2. nuk do te shqiptohet dënim më i rëndë se sa ai që është dhënë; dhe

1.3. personi nuk mund të ekstradohet tek shteti i tretë, pa lejen e Ministrit.

2. Ministri i Drejtësisë mund të vendos edhe kushte të tjera për ekstradim.

Neni 28

Ndjekja penale në rast të refuzimit të ekstradimit

Nëse lutja për ekstradim është refuzuar, Ministria njofton Prokurorinë e Qarkut, e cila mund të inicioj fillimin e procedurës penale në Kosovë, me lutje të shtetit lutës në përputhje me ligjin vendor kundër personit në Kosovë, lidhur me veprën penale për të cilën është kërkuar ekstradimi.

Neni 29

Komunikimi i vendimit

1. Ministri i Drejtësisë ia komunikon menjëherë shtetit lutës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme vendimin që lejon ekstradimin e personit.

2. Komunikimi me shtetin lutës do te realizohet përmes rrugëve diplomatike, përveç nëse është paraparë ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 30

Ekzekutimi i ekstradimit

1. Bazuar në vendimin e Ministrit për ekstradim, nëse personi nuk gjendet në paraburgim Gjykata do të lëshoj menjëherë urdhrin për arrestim deri sa të dorëzohet.

2. Në ditën kur të bëhet ekstradimi, policia do të dorëzojë personin tek autoritet kompetente të shtetit kërkues në vendin e caktuar për dorëzim.

3. Shteti kërkues do të pranojë personin brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita kur ka pranuar vendimin për ekstradimin e tij.

4. Ministri i Drejtësisë, bazuar në kërkesën e arsyetuar të shtetit kërkues mund të shtyj afatin e paraparë në paragrafin 3. të këtij neni edhe për pesëmbëdhjetë (15) ditë të tjera.

5. Nëse shteti lutës nuk e pranon personin e kërkuar për ekstradim, në pajtim me paragrafin 3. dhe 4. të këtij neni, personi menjëherë do të lirohet dhe Ministri i Drejtësisë mund të refuzoj kërkesën e përsëritur për ekstradim në lidhje me të njëjtën veprë penale.

Neni 31

Lutja e njëkohshme për ekstradim

1. Kur disa shtete kërkojnë ekstradimin e të njëjtit person për të njëjtën veprë penale, përparësi do të ketë shteti në territorin e të cilët është kryer vepra penale. Nëse vepra penale është kryer në territorin e më shumë shteteve ose vendi i kryerjes nuk është i njohur, përparësi do ti jepet shtetit i cili ka parashtruar i pari kërkesën për ekstradim.

2. Kur disa shtete kërkojnë ekstradimin e personit të njëjtë për disa vepra penale, përparësi do të ketë shteti në territorin e të cilit është kryer vepra më e rëndë penale. Nëse veprat penale janë të rëndësishme së njëjtë përparësi do të ketë shteti i cili ka parashtruar i pari kërkesën për ekstradim.

Neni 32
Procedura e thjeshtësuar për ekstradim

1. Personi për të cilën shteti lutës ka parashtruar lutje për ekstradim, mund të ekstradohet përmes procedurës së thjeshtësuar, nëse kushtet për ekstradim të parapara me këtë ligj janë përmbushur dhe nëse personi jep pëlqimin për ekstradimin e tij.
2. Pëlqimi i paraparë në paragrafin 1. të këtij neni do të jepet para gjykatës kompetente dhe do të regjistrohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, duke u siguruar që pëlqimi është dhënë mbi bazën vullnetare dhe personi ka qenë në dijeni për pasojat që do të rrjedhin. Pëlqimi i dhënë nuk mund të tërhiqet.
3. Vendimi për ekstradim përmes procedurës së thjeshtësuar duhet të aprovohet nga gjykata kompetente e qarkut.
4. Gjykata pa ndonjë vonesë do të lajmërojë Ministrinë në lidhje me vendimin e përmendur në pajtim me paragrafin 3. të këtij neni, dhe Ministria do të njoftoj shtetin lutës.
5. Ekstradimi përmes procedurës së thjeshtësuar do të ketë efekte dhe pasoja të njëjta ligjore sikur ekstradimi i lejuar përmes procedurës së rregullt.

Neni 33
Lutja për të kaluar transit nëpër territorin e Republikës së Kosovës

1. Në rastet kur ekstradimi është kërkuar nga një shtet në tjetrin dhe personi i ekstraduar duhet të kaloj transit përmes territorit të Republikës së Kosovës, në pajtim me lutjen e parashtruar nga shteti lutës, Ministri i Drejtësisë mund të jap lejen për personin e ekstraduar që të kaloj përmes territorit të Republikës së Kosovës, me kushtin që personi i ekstraduar nuk është shtetas i Kosovës dhe nuk është e lidhur me veprat penale politike dhe ushtarake.
2. Lutja për leje-transit duhet të shoqërohet me dokumentet e parapara në nenin 17 paragrafi 2. të këtij ligji.
3. Në rastet e kalimit transit përmes transportit ajror, nuk është e nevojshme të kërkohet leja e parashikuar si në paragrafin 1. të këtij neni, nëse nuk pritet që mjeti ajror do të ateroj në territorin e Republikës së Kosovës.
4. Në çdo rast, shteti lutës duhet të informoj Ministrinë lidhur me kalimin transit të parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni. Dokumenti informues duhet të përmbaj emrin e personit të ekstraduar, shtetin ku personi do të ekstradohet dhe kohën e transitit ajror.

KREU IV
EKSTRADIMI NGA SHETI I HUAJ NË KOSOVË

Neni 34
Lutja për ekstradim

1. Nëse procedura penale është në zhvillim e sipër në Kosovë kundër personit të kërkuar dhe dihet vendndodhja e tij, ose i njëjti është arrestuar në një shtet të huaj, ose nëse personi i kërkuar është dënuar nga gjykata vendore, Ministria mund të parashtrorjë kërkesë për ekstradimin e tij/saj në Kosovë.
2. Lutja do të dërgohet tek shteti i lutur përmes kanaleve diplomatike, së bashku me dokumentet dhe të dhënat e parapara në nenin 17 paragrafi 2. të këtij Ligji.

Neni 35
Lutja për arrest të përkohshëm në pritje të ekstradimit

1. Ministri i Drejtësisë mund të kërkojë arrestimin e përkohshëm të personit të kërkuar në pritje të ekstradimit, nëse ka ndonjë rrezik që personi i kërkuar për ekstradim në Kosovë, do të fshehët ose arratiset, dhe pavarësisht nga urdhër kërkimi ndërkombëtarë i lëshuar ndaj tij, personi vazhdon të jetë në liri.
2. Kërkesa për arrest të përkohshëm në pritje të ekstradimit do të theksojë se shkresat dhe informatat e parapara në nenin 17 paragrafi 2. të këtij ligji ekzistojnë dhe do të konfirmoj se ekstradimi do të kërkohet përmes kanaleve të rregullta.

Neni 36
Procedurat penale vendore

1. Personi i ekstraduar në Kosovë nuk do të ndiqet penalisht ose dënohet për asnjë veprë penale të kryer para dorëzimit të tij/saj për veç veprës penale për të cilën është lejuar ekstradimi, përjashtimisht kur shteti i lutur pranon. Shkresat e shtetit të lutur duhet të shoqërohen me dokumentet dhe të dhënat ligjore për çdo deklaratë të dhënë nga personi i ekstraduar në lidhje me veprën penale.
2. Kur ekstradimi është dhënë dhe i nënshtrohet kushteve të caktuara në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata do të jetë e detyruar që ti përmbahet këtyre kushteve gjatë shqiptimit të dënimit. Nëse zbatimi i ndonjë dënimi të dhënë tani më është i përfshirë, gjykata që ka gjykuar në shkallën e parë duhet të ndryshojë aktgjykimin dhe të shqiptoj dënimin si në kushtet e përcaktuara për lejimin e ekstradimit.
3. Nëse personi i ekstraduar ka qenë në paraburgim në shtetin e huaj për veprën penale për të cilën ai/ajo është ekstraduar, koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet në dënimin e shqiptuar.

KREU V
TRANSFERIMI I PROCEDURËS PENALE NGA SHTETET E HUAJA NË KOSOVË

Neni 37
Parimet

Procedura Penale e iniciuar apo qëllimi për të u iniciuar në shtetin e huaj mund të transferohet në Kosovë me lutjen e atij shteti, me kusht që ky i fundit ka kompetencë për të ndjekur penalisht atë veprë.

Neni 38
Kushtet për transferim

1. Transferimi i procedurës penale mund të pranohet në Kosovë vetëm nëse vepra për të cilën kërkohet transferimi është veprë penale edhe në Kosovë.
2. Transferimi i procedurës penale do të lejohet në rast se plotësohen kushtet e me poshtme në qoftë se:
 - 2.1. personi i dyshuar banon në Kosovë;
 - 2.2. personi është shtetas kosovar ose nëse Kosova është shteti i tij i origjinës;
 - 2.3. personi i dyshuar është duke mbajtur ose duhet të mbajë një dënim që përfshin heqjen e lirisë në Kosovë;

2.4. procedura për të njëjtën vepër ose vepra penale të tjera është iniciuar kundër personit në Kosovë.

3. Transferimi i procedurës penale nuk do të pranohet në qoftë se:

3.1. konsiderohet që vepra për të cilin është kërkuar transferimi i procedurës penale është e natyrës politike apo ushtarake;

3.2. në kohën e marrjes së kërkesës, procedura ishte ndaluar për shkak të parashkrimit; dhe

3.3. vepra penale është kryer jashtë territorit të shtetit lutës.

Neni 39 **Tërheqja e pranimit**

1. Pranimi i transferimit të procedurës penale mund të tërhiqet kur:

1.1. bëhet e qartë që prania e personit të dyshuar nuk mund të sigurohet në seancat gjyqësore në Kosovë ose që dënimi i cili mund të shqiptohet, nuk do të mund të zbatohet në Kosovë;

1.2. në qoftë se përpara se çështja të jetë paraqitur në gjyq bëhet e qartë një prej arsyeve për refuzim, të përmendur në nenin 38 të këtij ligji; ose

1.3. në raste të tjera, në qoftë se shteti kërkues pajtohet.

Neni 40 **Lutja për transferimin e procedurës penale**

1. Lutja për transferim të procedurës penale duhet të bëhet me shkrim dhe do të shoqërohet nga dokumente origjinale apo kopja e vërtetuar e dosjes penale, bashkangjitur me shkresat tjera të nevojshme.

2. Shteti lutës gjithashtu do të njoftojë Ministrinë lidhur me çdo veprim procedural të kryer ose mbi masat e ndërmarra pas dërgimit të kërkesës që ka të bëjë me procedurën penale. Këtij komunikimi duhet bashkangjitur dokumentet përkatëse.

Neni 41 **Përcjellja e lutjes**

1. Pas pranimit të lutjes për transferimin e procedurës penale, me kusht që lutja të jetë e plotësuar në pajtim me kushtet e parapara me nenin 40 paragrafi 1. të këtij ligji. Ministria do të përcjell menjëherë atë për veprim tek Prokuroria kompetente në territorin e të cilit personi në fjalë ka vendbanim.

2. Në qoftë se lutja i referohet transferimit në procedurë paraprake, ajo do të vendoset nga Prokurori i Qarkut. Nëse lutja i referohet transferimit të procedurës gjyqësore, Prokuroria e Qarkut do ta përcjell atë tek Gjykata Kompetente e Qarkut që të vendos, së bashku me kërkesën e tij apo saj.

3. Vendimi lidhur me lutjen për transferim të procedurës penale do të përcillet menjëherë tek Ministria.

Neni 42 **Komunikimi i vendimeve**

1. Ministria menjëherë do t'i komunikojë shtetit lutës vendimin mbi kërkesën për transferim të procedurës penale.

2. Ministria po ashtu do të njoftoj shtetin lutës për vendimin e marrë si rezultat i transferimit të procedurës penale. Shtetit lutës do t'i përcillet një kopje e vërtetuar e çdo vendimi të shqiptuar.

Neni 43

Vlefshmëria e veprimeve të marra në shtetin kërkues

1. Çdo veprim procedural lidhur me transferimin e procedurës penale të marrë në shtetin lutës në pajtim me ligjet dhe rregulloret e tij, do të jetë i barasvlershëm në Kosovë, sikur të ishte marrë nga organet gjyqësore vendore, me kusht që veprimet procedurale të jenë në pajtim me ligjin vendor.

2. Çdo veprim, i cili ndërprejë afatin dhe që është kryer në mënyrë të vlefshme në shtetin lutës, do të ketë të njëjtat pasoja në shtetin e Kosovës.

Neni 44

Procedura e iniciuar në bazë të Aktit akuzues

1. Nëse fillimi i procedurës varet nga akti akuzues si në Kosovë apo në shtetin lutës, akti akuzues i ngritur në shtetin lutës ka të njëjtin efekt juridik me atë të ngritur në Kosovë.

2. Nëse akti akuzues është e domosdoshme vetëm në Kosovë, transferimi i procedurës penale mund të pranohet edhe në mungesë të aktit akuzues nëse personi i cili ka të drejtë të ngritë akt akuzues nuk ka kundërshtuar një gjë të tillë brenda afatit prej një muaji nga data e pranimi të njoftimit nga organi kompetent lidhur me të drejtën e tij për të kundërshtuar.

KREU VI

TRANSFERIMI NGA KOSOVA PËR NË SHTET TË HUAJ

Neni 45

Parimet

Autoritetet gjyqësore në Kosovë mund të pezullojnë përkohësisht ndjekjen penale kundër një personi, vetëm në rastet kur janë plotësuar kushtet e parapara në kreun VI të këtij Ligji. Çdo vendim për pezullim të ndjekjes duhet të konsiderohet i përkohshëm deri sa vendimi në shtetin kërkues për pranimin e ndjekjes penale të bëhet i plotfuqishëm.

Neni 46

Kushtet e veçanta

1. Procedura penale mund të transferohet nëse:

1.1. transferimi është i nevojshëm me qëllim të arritjes tek e vërteta dhe në veçanti kur provat më të rëndësishme gjenden në shtetin e lutur;

1.2. është shqiptuar një dënim dhe zbatimi i dënimit në shtetin e kërkuar, ka gjasa të përmirësoj perspektivat e rehabilitimit social/shoqëror të personit të dënuar;

1.3. prezenca e personit të dyshuar në shqyrtimin gjyqësor në Kosovë nuk mund të sigurohet, ndërsa një gjë e tillë mund të bëhet në shtetin e kërkuar;

1.4. është shqiptuar një dënim kundër një personi dhe nuk mund zbatohet në Kosovë qoftë edhe duke kërkuar ekstradimin e tij/saj, ndërsa ky dënim mund të zbatohet në shtetin e lutur.

Neni 47
Organi gjyqësor që parashtrohet për kërkesën

Kërkesa për transferim të procedurës penale duhet të paraqitet nga prokurori kompetent përmes gjykatës kompetente, gjatë fazës së procedurës paraprake dhe deri sa të ngritët aktakuza dhe nga gjykata pas ngritjes së aktakuzës.

Neni 48
Efektet e transferimit

1. Kur kërkesa për transferim është parashtuar, personi që është subjekt i procedurës penale nuk mund të ndjeke penalisht për veprën penale që është objekt i procedurës transferimi i së cilës është kërkuar, dhe as vendimi i shpallur në Kosovë nuk mund të ekzekutohet kundër tij/saj. Përderisa nuk është pranuar vendimi i shtetit pranues lidhur me kërkesën për transferim të procedurës, autoritetet gjyqësore në Kosovë e ruajnë të drejtën të ndërmarrin të gjitha masat e ndjekjes me qëllim të sjelljes pa vonesë të rastit në gjykim.

2. E drejta e ndjekjes dhe e ekzekutimit duhet t'i kthehet autoriteteve gjyqësore vendore nëse shteti i lutur njofton lidhur:

- 2.1. me refuzimin për të vepruar në lidhje me kërkesën;
- 2.2. me vendimin për refuzimin e pranimin të kërkesës;
- 2.3. me vendimin për tërheqjen e pranimin të kërkesës;
- 2.4. me vendimin të mos iniciojë apo të ndërpresë procedurën;

3. Përveç rasteve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni, organi gjyqësor vendor mund të tërheq kërkesën për transferim para se shteti i lutur të njoftoj lidhur me vendimin për të vepruar në lidhje me kërkesën.

4. Në rast të dënimit, vendimi i formës së prerë i shpallur në shtetin e lutur prodhon të njëjtat efekte si të ishte vendim i shpallur në Kosovë.

KREU VII
TRANSFERIMI I PERSONAVE TË DËNUAR NGA KOSOVA NË SHETIN E HUAJ

Neni 49
Parimet

Personi i cili është dënuar me burgim në Kosovë dhe dëshiron të transferohet në shtetin e huaj, me qëllim të mbajtjes së dënimit apo pjesës së mbetur të dënimit, mund të paraqes lutje tek Ministria për transferim.

Neni 50
Kushtet për Transferim

1. Në përputhje me këtë ligj një person i dënuar mund të paraqet lutje për transferim vetëm pas plotësimit të kushteve në vijim, nëse:

- 1.1. personi është shtetas i Shtetit zbatues;
- 1.2. vendimi është i formës së prerë;

1.3. në kohën e pranimit të kërkesës për transferim, personi i dënuar ka ende të paktën gjashtë (6) muaj të dënimit për të vuajtur apo nëse dënimi është i pacaktuar;

1.4. personi i dënuar pajtohet me transferimin ose, duke marrë parasysh moshën ose gjendjen e tij fizike apo mendore; një pëlqim i tillë nevojitet nga përfaqësuesi i autorizuar;

1.5. veprimet apo mosveprimet, në bazë të cilave është dhënë dënimi, përbëjnë një vepr penale në përputhje me të drejtën e Shtetit zbatues dhe shtetit dënuar ose do të përbënte një vepr penale nëse do të ishte kryer në territorin e tij; dhe

1.6. shteti zbatues jep pëlqimin për transferim.

2. Në raste të veçanta, Ministria mund të shqyrtojë lutjet për transferim edhe nëse koha që duhet të mbahet nga personi i dënuar është më e shkurtër se ajo e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni.

Neni 51 **Obligimi i dhënies së informatave**

1. Çdo shtetas i huaj i dënuar me vendim të formës së prerë në Kosovë, për të cilin zbatohet ky ligj informohet me dispozitat e këtij Kreu.

2. Nëse personi i dënuar ka shprehur interes për t'u transferuar në pajtim me këtë ligj, Ministria njofton Shtetin e huaj sa më shpejt që të jetë e mundur pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë.

3. Njoftimi përmban:

3.1. emrin, datën dhe vendin e lindjes së personit të dënuar;

3.2. adresën e tij, nëse ka, në Shtetin zbatues;

3.3. përshkrimin e fakteve mbi të cilat është bazuar dënimi; dhe

3.4. natyrën, kohëzgjatjen dhe datën e fillimit të dënimit.

4. Nëse personi i dënuar ka shprehur interesimin për transferim Shtetit zbatues, Ministria në bazë të lutjes së shtetit zbatues i komunikon atij Shteti informacionin e përmendur në paragrafin 3. të këtij neni.

5. Personi i dënuar njoftohet me shkrim në gjuhën të cilën ai e kupton për çdo veprim të ndërmarrë nga autoritetet e Kosovës ose nga shteti zbatues në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, si edhe çdo vendim nga secili shtet lidhur me lutjen për transferim.

Neni 52 **Pëlqimi dhe konfirmimi**

Ministria duhet të sigurojë që personi i cili jep pëlqimin për transferim, këtë e bën në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije të plotë për pasojat ligjore.

Neni 53 **Dokumentet shtesë**

1. Lutja për transferim nga Ministria tek shteti i huaj duhet të bëhen në mënyrë të shkruar.

2. Lutjes duhet bashkangjitur dokumentet në vijim:

2.1. origjinali apo kopja e vërtetuar e aktgjykimit dhe ekstrakti i ligjit në të cilin bazohet;

2.2. deklaratë mbi masën e dënimit të mbajtur, përfshirë informatat e kohës së kaluar në paraburgim; apo çdo informata tjetër lidhur me zbatimin e dënimit;

2.3. deklaratë me shkrim për dhënien e pëlqimit për transferim nga i dënuari;

2.4. kur është e nevojshme, raport mjekësor apo social mbi të dënuarin, informata lidhur me trajtimin e tij në Kosovë, dhe çdo rekomandim tjetër lidhur me trajtimin e tij në shtetin zbatues.

3. Ministria para dërgimit të kërkesës për transferim, mund të kërkojë nga shteti zbatues të sigurojë:

3.1. dokument apo deklaratë me të cilën vërtetohet se personi i dënuar është shtetasi i atij shteti;

3.2. kopje të ligjit të aplikueshëm të shtetit zbatues i cili përcakton veprimet apo mos veprimet mbi të cilën është bazuar dënimi i shqiptuar dhe baza ligjore me të cilën vërtetohet se vepra për të cilën është dënuar parashihet vepër penale sipas ligjit të shtetit zbatues, apo do të përbente vepër penale nëse do të kryhej në atë shtet;

3.3. deklaratë mbi procedurën e zbatimit të dënimit, në vazhdimin e ekzekutimit të dënimit apo përmes përshtatjes së dënimit.

Neni 54

Transferimi i Personave të dënuar në bazë të urdhrit për deportim apo dëbim

1. Ministria mund të jap pëlqimin për transferimin e personit të dënuar pa pëlqimin e tij, kur dënimi i shqiptuar është dhënë përmes urdhrit për dëbim apo deportim apo ndonjë masë tjetër si rezultat i së cilës personi nuk lejohet të qëndrojë në territorin e Kosovës pasi që ai/ajo lirohet nga burgu.

2. Ministri do të jap pëlqimin e tij në bazë të paragrafit 1 vetëm pasi të ketë marrë në konsideratë edhe opinionin e personit të dënuar.

3. Ministria duhet të i sigurojë shtetit zbatues dokumentet e më poshtme:

3.1. deklaratë që përmban mendimin e personit të dënuar lidhur me transferimin e tij/saj; dhe

3.2. kopjen e urdhrit për deportim apo dëbim apo ndonjë urdhri tjetër që ka efekt ligjor me të cilin personit të dënuar i ndalohet qëndrimi në territorin e Kosovës pasi që ai/ajo është liruar nga burgu.

Neni 55

Efektet e transferimit

1. Dorëzimi i personit të dënuar tek autoritetet e shtetit zbatues do të ketë efektin e suspendimit të ekzekutimit të dënimit në Kosovë.

2. Autoritetet Kosovare nuk do të ekzekutojnë dënimin nëse shteti zbatues konsideron se ekzekutimi i dënimit është përfunduar.

KREU VIII
TRANSFERIMI NË KOSOVË I PERSONIT TE DËNUAR NGA SHTETI I HUAJ

Neni 56
Parimet

1. Shteti dënues mund të kërkojë nga Ministria te jap pëlqimin lidhur me transferimin në Kosovë të personit te dënuar ndaj te cilit është shqiptuar ndonjë dënim ne atë shtet, më qëllim qe ai/ajo të mbajë dënimin apo pjesën e mbetur te dënimit në Kosovë.
2. Lutja me shkrim për transferim në Kosovë duhet bëhet nga i dënuari apo në emër te të dënuarit.
3. Ministri mund te jap pëlqimin për transferim nëse kushtet e parapara me nenet 50 dhe 53 të këtij ligji janë plotësuar.

Neni 57
Efektet e transferimit

Organi kompetent gjyqësor në Kosovë do të përshtat dënimin e shqiptuar nga shteti dënues ne dënim te aplikueshëm në Kosovë, përmes procedurës gjyqësore në përputhje me kushtet e përcaktuara ne nenin 58 të këtij ligji.

Neni 58
Përshtatja e dënimit

1. Gjykata gjatë përshtatjes së dënimit duhet:
 - 1.1. të obligohet që të respektojë sa më shumë qe është e mundshme faktet e paraqitura ne dënimin e shqiptuar nga shteti dënues;
 - 1.2. të mos konvertojë dënimin me burgim në dënim me gjobë;
 - 1.3. të përfshij tërë kohën e mbajtur të dënimit në shtetin dënues nga personi i dënuar qe nga koha e privimit nga liria; dhe
 - 1.4. nuk do të përkeqësojë pozitën penale te personit te dënuar, dhe nuk do të obligojë ndonjë minimum te caktuar në bazë të ligjit te shtetit dënues qe mund të përcaktojnë për veprën e kryer.
2. Procedura e përshtatjes të dënimit do të kryhet pas transferimit te personit te dënuar. Gjykata duhet ta mbajë personin ne paraburgim apo të sigurojë praninë e tij deri në përfundim te procedurës.

Neni 59
Personat e ikur nga shteti dënues

1. Në rastet kur shtetasi Kosovar i cili është subjekt i një dënimi të shqiptuar në territorin e shtetit të huaj si pjesë e aktgjyqimit përfundimtar, tenton t'i ikë ekzekutimit të mëtejme të dënimit në Shtetin e huaj përmes arratisjes në territorin e Kosovës, para se të ketë mbajtur dënimin, me kërkesë te shtetit të huaj Ministria mund te pajtohet të merr përsipër ekzekutimin e dënimit në Kosovë.
2. Me kërkesë të Shtetit ku personi është i dënuar, organet gjyqësore në Kosovë mund, para arritjes së dokumenteve mbështetëse të kërkesës, ose para vendimit mbi këtë kërkesë, të arrestojë personin e dënuar apo të marrë çfarëdo qoftë mase tjetër për të siguruar që personi i dënuar të mbetet në territor të tij, në pritje të vendimit për kërkesën. Lutja për arrest të përkohshëm duhet të përfshijnë përmendurat dhënat e parapara në paragrafin 3. të neni 53 të këtij ligji. Pozita juridike e personit të dënuar nuk duhet të përkeqësohet si rezultat i çfarëdo qoftë periudhe të kaluar në arrest, duke u bazuar në këtë paragraf.

3. Pëlqimi i personit të dënuar nuk do të kërkohet për transferimin e ekzekutimit të dënimit.

Neni 60

Garancia për personin e dënuar të transferuar pa pëlqimin e tij

1. Çdo person i transferuar në Kosovë pa vullnetin e tij/saj në bazë të urdhrimit për deportim apo nuk do të ndjeket penalisht apo dënohet apo paraburgoset më qëllim të mbajtjes së dënimit apo të zbatimit të ndonjë urdhri tjetër për arrest, për ndonjë veprë penale të kryer para transferimit të tij/saj, si dhe ai/ajo nuk do të privohet nga liria, përveç për veprën për të cilën është lejuar transferimi, dhe atë vetëm nëse shteti dënues e autorizon një gjë të tillë. Autorizimi nga shteti dënues duhet të këtë të bashkangjitur të gjitha dokumentet relevante dhe deklaratën e regjistruar në procesverbal të bërë nga i dënuari; autorizimin duhet të epet kur vepra për të cilën është kërkuar do të lejohet transferimi në bazë të ligjit të shtetit dënues dhe ligjit vendor apo kur transferimi nuk do të mundësohet për shkak të masës së dënimit.

2. Pavarësisht prej dispozitave nga paragrafi 1. i këtij neni, organet gjyqësore vendore mund të marrin masa të domosdoshme në bazë të ligjit vendor për të parandaluar parashkrimin.

Neni 61

Përfundimi i ekzekutimit

Ekzekutimi i dënimit do të përfundojë se zbatuari nëse shteti dënues nxjerr vendim apo ndonjë masë tjetër me të cilën dënimi pushon të jetë i ekzekutueshëm pasi ministria të jetë informuar nga shteti përkatës për një vendim të tillë.

Neni 62

Informacioni për ekzekutimin

1. Ministria njofton shtetin e huaj në lidhje me ekzekutimin e dënimit:

1.1 kur ai e konsideron ekzekutimin e dënimit të përfunduar;

1.2. nëse personi i dënuar është arratisur nga mbajtja para se të përfundojë vuajtjen e dënimit; ose

1.3. kur shteti i huaj kërkon një raport të veçantë.

Neni 63

Leja për kalim transit të personit të dënuar

1. Ministria në përputhje me ligjin vendor mund të miratojë lutjen për kalim transit të personit të dënuar përmes territorit të Kosovës, nëse një kërkesë e tillë është bërë nga shteti i huaj, dhe ai shtet është pajtuar me një shtet tjetër për transferimin e atij personi për apo nga territori i tij.

2. Ministria mund të refuzojë lejen për të kaluar transit:

2.1. nëse personi i dënuar është shtetas kosovar;

2.2. nëse vepra për të cilën është shqiptuar dënimi nuk është paraparë si veprë penale në bazë të ligjit vendor.

3. Personi i dënuar mund të mbahet në mbajtje në paraburgim në territorin e Kosovës vetëm për aq kohë sa nevojitet për kalimin transit.

4. Nuk do të nevojitet leje për transit ne rast se transferimi bëhet përmes transportit ajror nëpër territorin e Kosovës dhe nuk parashihet te këtë zbritje në territorin e Kosovës.

5. Për çdo rast, shteti kërkues duhet të informojë Ministrinë lidhur me kalimin Transit të paraparë në paragrafin 4 te këtij neni. Informatat duhet te tregojnë shtetin dhe emrin e personit te transferuar, shteti ku personi do të transferohet dhe kohën e fluturimit.

KREU IX EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË HUAJA NË KOSOVË

Neni 64 Parimet

1. Gjykata vendore mund të pranoj lutjen e gjykatës së huaj për të njohur dhe ekzekutuar vendimin e shpallur kundër shtetasit apo banorit të Kosovës, nëse vendimi parasheh dënim me burgim, dënim me gjobë, konfiskim të pasurisë ose ndalimin e ushtrimit te profesionit, aktiviteteve apo detyrës.

2. Shteti dënues mund të parashtrorë lutjen për ekzekutimin e dënimit tek Ministria. Lutjes për ekzekutim duhet t'i bashkëngjitet origjinali apo kopja e vërtetuar e dënimit i cili duhet të ekzekutohet dhe dokumentet e tjera të nevojshme. Nëse lutja është e pranueshme, Ministria do të përcjellë atë tek Gjykata kompetente.

3. Gjykatë kompetente do të jetë Gjykata e Qarkut, në territorin e së cilës personi i dënuar ka vendbanimin e përhershëm. Nëse personi i dënuar nuk ka vendbanim të përhershëm në Kosovë, juridiksioni territorial do të përcaktohet në bazë të vendit të lindjes së tij/saj. Nëse personi nuk është i lindur në Kosovë, gjykatë kompetente do të jetë Gjykata e Qarkut në Prishtinë.

Neni 65 Procedura gjyqësore

1. Gjykata, në kolegji prej tre gjyqtarësh, do të marrë aktgjykim me të cilin do të njoh dhe ekzekutojë sanksionin e shqiptuar me vendimin e gjykatës së huaj nëse:

1.1. vepra penale nuk është objekt i ndonjë aktgjykimi të shpallur nga gjykata në Kosovë apo nuk ka qenë objekt i procedurës penale në Kosovë.

1.2. në bazë të ligjit vendor, dënimi nuk është parashkruar apo falur.

1.3. të pandehurit i është mundësuar e drejta të dëgjohet para gjykatës së huaj, dhe nuk ka arsye për të besuar se ai/ajo nuk ka pas gjykim të drejtë.

1.4. vepra për kryerjen e së cilit është shpallur dënimi, do të konsiderohej vepër penale po të ishte kryer në territorin e Kosovës dhe personi kundër të cilit është shqiptuar dënimi do të ishte penalisht i përgjegjshëm.

2. Para shpalljes së aktgjykimit, gjykata do të dëgjoj personin e dënuar nëse ai/ajo nuk gjendet në paraburgim në shtetin kërkues. Në këtë rast personi i dënuar mund të dëgjohet duke parashtruar letërporsi, në të kundërtën gjykata do të pezullojë marrjen e vendimit deri në sigurimin e prezencës së atij personi në Kosovë. Në seancën dëgjimore do të jetë prezent edhe prokurori.

3. Gjykata njeh konstatimet e gjykatës së huaj sa i përket gjendjes faktike për aq sa është paraqitur në përmbajtjen e vendimit të huaj.

4. Në dispozitiv të aktgjykimit gjykata do të shënon në tërësi dispozitivin e vendimit të gjykatës së huaj dhe do të cekë emrin e gjykatës që ka lëshuar atë vendim, dhe shqipton dënimin. Në arsyetim të aktgjykimit shënohen arsyet të cilat janë marrë parasysh me rastin e shqiptimit të sanksionit.

5. Dënimi i shqiptuar mund të jetë i një natyre apo kohëzgjatje tjetër nga ajo e dënimit të shqiptuar nga gjykata e huaj, përderisa nuk është më i rëndë. Nëse dënimi i shqiptuar nga gjykata e huaj nuk arrin minimumin e lejuar për shqiptimin e dënimit në bazë të ligjit vendor, gjykata pavarësisht nga ky minimum shqipton sanksion përkatës që përputhet me dënimin e shqiptuar nga gjykata e huaj.

6. Çdo pjesë e mbajtur e sanksionit të shqiptuar në shtetin e huaj dhe koha e qëndrimit në paraburgim të të dënuarit pas dënimit në shtetin e huaj ose në Kosovë, llogaritet në dënim.

7. Ankesë kundër aktgjykimit vendor mund të paraqesë prokurori, i dënuari dhe mbrojtësi i tij.

Neni 66

Arrestimi i përkohshëm në bazë të kërkesës për ekzekutim të vendimit të huaj

1. Nëse shteti i huaj ka parashtruar lutje për ekzekutim, personi i dënuar mund të arrestohet nëse për veprën e tillë penale në bazë të KPPK kërkohet paraburgimi si dhe rrethanat specifike tregojnë se ka rrezik i kjeje.

2. Kur organi i huaj paralajmëron qëllimin e tij për paraqitje të lutjes për ekzekutim të vendimit, personi i dënuari, me kërkesë të organit të huaj mund të arrestohet nëse plotësohen kushtet e parapara në paragrafin 1. të këtij neni. Lutja e tillë përfshin veprën penale për të cilin është marrë aktgjykimi dënues, kohën dhe vendin e kryerjes së saj dhe përmban përshkrimin sa më të saktë të mundshëm të të dënuarit. Lutja gjithashtu përmban një deklaratë të shkurtër të fakteve në të cilat mbështetet aktgjykimi.

3. Personi i dënuar mbahet në paraburgim në pajtim me dispozitat e KPPK.

4. Personi në paraburgim në çdo rast lirohet:

4.1 pas kalimit të afatit të njëjtë me afatin e privimit të lirisë të shqiptuar me aktgjykim dënues; ose

4.2. nëse është arrestuar sipas paragrafit 2. të këtij neni dhe lutja për ekzekutim së bashku me dokumentet e nevojshme nuk është marrë brenda tetëmbëdhjetë (18) ditëve nga dita e arrestimit.

Neni 67

Ekzekutimi i dënimit me gjobë dhe konfiskimi i parave

1. Kur lutja për ekzekutimin e dënimit me gjobë dhe konfiskimin e parave është pranuar, gjykata konverton këtë shumë në valutën që është në qarkullim në Kosovë sipas kursit të këmbimit në kohën kur është marrë vendimi. Në këtë mënyrë, gjykata do të caktojë vlerën e dënimit me gjobë apo shumën që do të konfiskohet, e cila nuk mund të tejkalojë maksimumin e përcaktuar me ligj vendor për veprën e njëjtë penale.

2. Kur lutja për ekzekutim ka të bëjë me konfiskimin e një objekti të veçantë, gjykata mund të urdhërojë konfiskimin e atij objekti vetëm nëse konfiskimi i tillë për atë vepër penale lejohet në bazë të ligjit vendor apo lejon caktimin e një sanksioni më të rëndë.

Neni 68
Arkëtimi i dënimit me gjobë dhe konfiskimit

1. Të ardhurat nga arkëtimi i gjobës dhe konfiskimit duhet të derdhen në buxhetin e Kosovës, përveç nëse është pajtuar ndryshe me shtetin kërkues dhe pa paragjykuar në të drejtat që palët e treta mund të kenë.
2. Pasuria e konfiskuar e cila është e interesit të veçantë, mund t'i kthehet shtetit kërkues nëse ai e kërkon atë.

Neni 69
Ekzekutimi i dënimit plotësues

1. Kur është bërë lutja për ekzekutimin e dënimit mbi ndalimin e ushtrimit të profesionit, aktivitetit apo detyrës, një dënim i tillë i shpallur në shtetin lutës mund të lejohet në Kosovë vetëm në rast se ligji vendor parasheh shqiptimin e dënimit të tillë për veprën penale në fjalë.
2. Nëse gjykata urdhëron ekzekutimin e dënimit plotësues, ajo do të caktojë kohëzgjatjen e dënimit plotësues brenda limiteve të përcaktuara me ligj vendor, por nuk mund të tejkalojë limitet e parapara në sanksionin e shqiptuar nga shteti lutës.

KREU X
EKZEKUTIMI I VENDIMEVE VENDORE NË SHTETIN E HUAJ

Neni 70
Lutja për ekzekutim dhe dokumentet mbështetëse

Lutja për ekzekutim mund të paraqitet në formë të shkruar nga gjykata vendore kompetente tek Ministria dhe duhet të shoqërohet nga origjinali ose kopja e vërtetuar e vendimit ekzekutimi i të cilit kërkohet dhe nga të gjitha dokumentet tjera të nevojshme, duke përfshirë deklaratën me të cilën vërtetohet lejueshmëria e ekzekutimit të sanksionit.

KREU XI
LETËR POROSITË NGA KOSOVA PËR TË SHTETI I HUAJ

Neni 71
Organi që paraqet letër porosinë tek shteti i huaj

1. Gjatë procedurës paraprake deri në ngritjen e aktakuzës, letër-porositë mund të paraqitet nga prokurori kompetent, përveç nëse dispozitat e KPPK parashohin se nevojitet urdhër nga gjykata.
2. Pas ngritjes së aktakuzës, letër porositë mund të paraqitet vetëm nga gjykata kompetente.
3. Letër porositë e organeve gjyqësore vendore u dërgohen organeve kompetente të shtetit përkatës përmes Ministrisë.

Neni 72
Sekreti

Ne rastet kur sekreti duhet ruajtur, dhe kur shteti i huaj pranon, Ministria mund të lejojë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë në mes të organeve gjyqësore vendore dhe organeve gjyqësore të shtetit të huaj.

KREU XII
LETËR POROSITË NGA SHETI I HUAJ NË KOSOVË

Neni 73

Lejimi i ekzekutimit te letër porosisë

1. Ministria pas pranimit të letër porosisë, dhe konstatimit se është e lejueshme, e dërgon për ekzekutim te zyra kompetente e prokurorit te qarkut ne territorin ku personi banon apo mund te gjendet.
2. Nëse letër porosia nuk është e plotë, Ministria e kthen mbrapa tek shteti lutës për plotësimin e kërkesës.

Neni 74

Refuzimi i ofrimit të ndihmës

1. Ministria mund të refuzojë ofrimin e ndihmës nëse:
 - 1.1. lutja lidhet me vepër politike;
 - 1.2. ekzekutimi i kërkesës do të paragjykonte sovranitetin, sigurinë apo rendin publik apo interesat tjera esenciale te Kosovës.

Neni 75

Organi qe ekzekuton letër porositë

1. Prokurori i qarkut duhet të ekzekutojë kërkesën në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç nëse nuk kërkohet ndonjë masë e urdhëruar me Kodin e Procedurës Penale. Nëse kërkohet urdhri nga gjykata, prokurori kompetent do t'ia paraqes kërkesën e nevojshme gjykatës.
2. Nëse prokurori i qarkut përgjegjës për ekzekutimin e letër-porosisë për ndihmë juridike vendos se letër-porosia nuk i plotëson kushtet e parapara me ligjin vendor, e kthen prapa të njëjtën përmes Ministrisë për tek autoriteti i huaj se bashku me arsyetim.

Neni 76

Shtyrja e ekzekutimit te kërkesës

1. Pas kërkesës se Prokurorit apo gjyqtarit kompetent, Ministria do të informojë shtetin e huaj lidhur me shtyrjen e ekzekutimit te letër-porosisë nëse kjo do të pengonte ne hetimin, ndjekjen penale apo procedurën gjyqësore qe është duke u zhvilluar në Kosovë.
2. Para refuzimit apo shtyrjes se ofrimit të ndihmës, Ministria kur është e nevojshme dhe pas konsultimit me shtetin kërkues, mund te vendos nëse letër-porosia te lejohet pjesërisht, apo të caktojë kushte qe mund te i konsiderojë te domosdoshme,
3. Shteti lutës do të informohet lidhur me arsyet e shtyrjes se ofrimit te ndihmës.

Neni 77

Pjesëmarrja e zyrtareve të huaj

1. Ministria do të informojë shtetin e huaj për datën dhe vendin e ekzekutimit të letër porosisë, nëse një kërkesë e tillë kërkohet nga shtetit lutës.
2. Ministria mund të lejojë pjesëmarrjen e zyrtareve të huaj në ekzekutimin e letër-porosive për ndihmë juridike ndërkombëtare. Pjesëmarrja e zyrtareve të huaj mund të lejohet nëse pjesëmarrja e tillë do të lehtësonte ne ekzekutimin e letër porosisë ne përputhje me nevojat e shtetit lutës ku njëkohësisht edhe do të shmangej nevoja për ndonjë kërkesë plotësuese për ndihmë juridike ndërkombëtare.

Neni 78
Dëgjimi përmes mjeteve te telekomunikimit

1. Kur shteti kërkues kërkon qe një person i cili gjendet ne territorin e Kosovës te merret ne pyetje ne cilësinë e dëshmitarit apo ekspertit nga autoritet gjyqësore te shtetit te huaj, dhe kur personi nuk është e mundshme qe personalisht te paraqitet ne territorin e shtetit kërkues, marrja ne pyetje mund te mundësohet përmes mjeteve te telekomunikimit.
2. Lutja për marrje në pyetje përmes mjeteve te telekomunikimit duhet të përmbajë arsyen pse nuk është e mundshme apo e dëshirueshme qe personi te paraqitet personalisht, emrin e organit gjyqësor dhe personave qe do të udhëheqin seancën dëgjimore.
3. Gjykata kompetente e qarkut do të ftoj personin përkatës qe te paraqitet ne përputhje me kushtet e paraqitura në ligjin vendor.
4. Marrja në pyetje përmes mjeteve te telekomunikimit bëhet në pajtim me rregullat e me poshtme:
 - 4.1. marrja ne pyetje duhet te realizohet ne prani te gjyqtarit, i cili është përgjegjës për vërtetimin e identitetit të personit qe do të merret ne pyetje dhe respektimin e te drejtave themelore te tij, të përcaktuara me ligjin vendor;
 - 4.2. shteti kërkues dhe Ministria duhet te pajtohen lidhur me masat për mbrojtjen e personit qe do të merret në pyetje;
 - 4.3. marrja ne pyetje mund te udhëhiqet drejtpërdrejtë apo nen direktivat e organeve gjyqësore te shtetit kërkues në përputhje me ligjin e shtetit kërkues;
 - 4.4. me kërkesë te shtetit kërkues apo personit qe do të merret në pyetje, gjyqtari sigurohet qe gjatë marrjes ne pyetje te sigurohet përkthyesi, nëse kjo është e nevojshme; dhe
 - 4.5. personi qe do te merret ne pyetje mund të shfrytëzojë te drejtën për te mos dhënë dëshminë e cila do ta rëndonte situatën e tij apo saj sipas ligjit të Kosovës apo të shtetit kërkues.
5. Duke mos paragjykuar asnjë nga masat e ndërmarra me qëllim të mbrojtjes së personit, në përfundim të dëgjimit duhet të mbahet procesverbal, në të cilin do të përfshihet data dhe vendi i mbajtjes së dëgjimit, identiteti i personit të dëgjuar, identiteti dhe funksioni i të gjithë personave të tjerë në Kosovë që kanë marrë pjesë në dëgjim, çdo betim të dhënë si dhe kushtet teknike në bazë te të cilave është mbajtur dëgjimi. Dokumenti duhet t'i dërgohet autoriteteve kompetente të shtetit kërkues.
6. Në bazë të kërkesës së huaj, organet gjyqësore vendore mund të zbatojnë dispozitat e këtij neni në dëgjimin e të pandehurit përmes video konferencës. Në këtë rast, vendimi për mbajtjen dhe mënyra e mbajtjes së video konferencës do të bëhet në përputhje me legjislacionin vendor. Dëgjimi i të pandehurit mund të bëhet vetëm me pajtimin e tij/saj.

Neni 79
Kontrollimi dhe konfiskimi

1. Letër porosia për kontrollim dhe konfiskim të pasurisë duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:
 - 1.1. që vepra që ka shkaktuar paraqitjen e kërkesës të jetë e dënueshme në bazë të ligjit të shtetit kërkues dhe ligjit vendor; dhe
 - 1.2. që ekzekutimi i kërkesës të jetë në përputhje më legjislacionin vendor.

Neni 80
Dorëzimi i pasurisë

1. Çdo pasuri, si dhe dokumentet origjinale, të dorëzuara në ekzekutimin e letër porosisë do të kthehen në Kosovë nga shteti lutës sa më shpejt që të jetë e mundur, përveç nëse Ministria heq dorë nga kthimi i tyre.
2. Dorëzimi i pasurisë, materialeve gjyqësore ose dokumenteve të kërkuara mund të vonohet nëse pasuria, materialet gjyqësore ose dokumentet në fjalë, kërkohen në Kosovë në lidhje me procedurat penale në pritje.

Neni 81
Dërgimi dhe kthimi i dokumenteve dhe dëshmimeve

Çdo dokument origjinal dhe dëshmitë e dërguara gjatë ekzekutimit të letër-porosisë, do të kthehen nga shteti kërkues sa më shpejt që të jetë e mundur, përveç nëse organet gjyqësore të Kosovës heqin dorë nga kthimi i tyre.

KREU XIII
SHËRBIMI I LETËRTHIRRJEVE DHE DOKUMENTEVE GJYQËSORE

Neni 82
Shërbimi i dokumenteve dhe letërthirrjeve

1. Gjykata kompetente komunale do të ofroj ndihmë në shërbimin e letërthirrjeve dhe vendimeve gjyqësore të cilat janë të dërguara nga shteti lutës për këtë qëllim.
2. Shërbimi do të bëhet në mënyrë të njëjtë me atë të rregulluar nga ligji vendor për shërbimin e dokumenteve të ngjashme, ndërsa nëse kjo nuk është e mundshme, atëherë letërthirret apo dokumentet vetëm do të dorëzohen tek personi tek i cili duhet të bëhet shërbimi. Ministria do të njoftojë shtetin lutës lidhur me mënyrën e dorëzimit.
3. Dëshmia për dorëzim do të jepet me vërtetimin e nënshkruar me datë nga personi të cilit do të dorëzohen, dhe nëse nuk është e mundur, me anë të deklaratës që shërbimi është realizuar dhe përmban formën dhe datën e këtij dorëzimi. Nëse dorëzimi nuk mund të realizohet, gjykata do të cekë arsyet pse shërbimi nuk ka mundur të realizohet dhe të njëjtat përmes Ministrisë do të i komunikohen shtetit lutës sa më parë që është e mundur.

Neni 83
Shërbimi i ftesave për dëshmitarët, ekspertët, të pandehurit që të paraqiten para organeve gjyqësore të shtetit kërkues

1. Nëse shteti lutës kërkon paraqitjen personale të dëshmitarit ose ekspertit para organeve gjyqësore të tyre, ose kërkon paraqitje vullnetare të të pandehurit përmes shërbimit të letër thirrjes, Ministria përmes organit gjyqësor do të ftojë dëshmitarin ose ekspertin që të paraqitet.
2. Ministria do të njoftoj shtetin lutës lidhur me përgjigjen nga dëshmitari ose eksperti.
3. Dëshmitari, eksperti ose i pandehuri të cilëve u është kërkuar që të paraqiten para organeve kompetente dhe nuk i janë përgjigjur ftesës që të paraqiten, nuk do të ndërmerret ndonjë ndëshkim apo masë tjetër.

Neni 84

Garantimi për Dëshmitarin, ekspertin dhe të pandehurin kur ftohet para organeve të Kosovës

1. Dëshmitari ose eksperti i cili paraqitet para organeve gjyqësore të Kosovës pa marrë parasysh shtetësinë e tij nuk do të ndiqet penalisht, të arrestohet ose të jetë subjekt i asnjë kufizimi të tij/saj në territorin e Republikës së Kosovës në lidhje me veprat ose dënimin para largimit nga territori i Republikës së Kosovës.
2. Personi pa marrë parasysh shtetësinë e tij i cili paraqitet para organeve gjyqësore të Kosovës që të përgjigjet për veprimet e tij që lidhen me procedurën kundër tij nuk do të ndiqet penalisht, arrestohet ose të jetë subjekt i asnjë kufizimi të tij/saj në territorin e Republikës së Kosovës në lidhje me veprimin ose dënimin para largimit nga territori i Republikës së Kosovës dhe kur një gjë e tillë nuk është specifikuar në ftesë.
3. Imuniteti i dhënë në këtë nen do të pushojë nëse dëshmitari, eksperti ose personi i pandehur, ka pasur një periudhë kohore prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh që të largohet pasi që prezenca e tij me nuk ka qenë e kërkuar nga organet gjyqësore, dhe megjithatë ka qëndruar në territorin e Kosovës, ose e ka lënë atë dhe më pas është kthyer.

Neni 85

Transferimi i përkohshëm i personave në arrest për të dëshmuar para organeve gjyqësore në shtetin lutës

1. Personi i arrestuar prania e të cilit kërkohet nga një shtet i huaj të paraqitet si dëshmitar për qëllime të ballafaqimit, do të transferohet përkohësisht në territorin ku dëgjimi është paraparë të mbahet, me kusht që ai/ajo do të kthehet në Kosovë brenda periudhës së përcaktuar nga Ministria.
2. Transferimi mund të refuzohet në qoftë se:
 - 2.1. personi në arrest nuk pajtohet,
 - 2.2. prezenca e tij është e domosdoshme në pritje të procedurës penale në territorin e Kosovës;
 - 2.3. transferimi i tij ka të bëjë me zgjatjen e paraburgimit, ose
 - 2.4. ekzistojnë rrethana tjera për të mos lejuar transferimin e tij në shtetin lutës.
3. Kalimi transit i personit në arrest përmes territorit të Kosovës mund të lejohet nëse Ministria e Drejtësisë së shtetit lutës paraqet kërkesë për leje për kaluar transit të shoqëruar me të gjitha dokumentet e domosdoshme, drejtuar Ministrisë.

KREU XIV

TE DHËNAT GJYQËSORE DHE TË DHËNA TË TJERA

Neni 86

Lutja për të dhënat penale

Me lutje të shtetit të huaj, ekstraktet dhe informatat lidhur me të dhënat gjyqësore do të komunikohen atij shteti, duke siguruar se ajo informatë është e nevojshme për çështjen penale në shtetin lutës.

Neni 87
Shkëmbimi i informatave nga të dhënat gjyqësore

Ministria do ta informojë çdo shtet të huaj për të gjitha dënimet penale dhe masat plotësuese sa i përket shtetasve të atij shteti, të regjistruar në të dhënat gjyqësore. Kur personi në fjalë është shtetas i dy apo më shumë shteteve, informata do ti epet secilit nga këto shtete.

Neni 88
Shkëmbimi i informatave

Pa cenuar zhvillimin e hetimeve ose procedurës, organi kompetent gjyqësor në Kosovë, mundet që, pa kërkesë paraprake, t'ia përcjell organit kompetent të shtetit të huaj informatat e siguruar në kuadër të hetimeve të tyre, kur konsiderojnë se zbulimi i informatave të tilla mund të ndihmojë shtetin pranues në iniciimin apo marrjen përsipër të hetimeve ose të procedimeve, ose mund të shpie në një lutje për ndihmë juridike të ndërsjellë nga ai shtet.

KREU XV
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 89
Shpenzimet

1. Shpenzimet lidhur me ekstradimin nga Kosova në shtetin e huaj, të shkaktuara jashtë territorit të Kosovës, do të kompensohen nga shteti lutës.
2. Shpenzimet lidhur me ekstradimin nga shteti i huaj për në Kosovë, dhe në bazë të kërkesës se Ministrisë duhet të kompensohen nga buxheti i Kosovës.
3. Shpenzimet e tjera të shkaktuara në ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare në bazë të këtij ligji në territorin e Kosovës, do të barten nga buxheti i Kosovës.

Neni 90
Mbrojtja e të dhënave personale

1. Te dhënat personale të transferuara në Kosovë si rezultat i ekzekutimit të një kërkesë në bazë të këtij ligji, mund të shfrytëzohen nga organet gjyqësore në Kosovë vetëm:
 - 1.1. për qëllime të procedurave që përcakton ky ligj;
 - 1.2. për procedura tjera gjyqësore dhe administrative që ndërlidhen drejtpërdrejtë me procedurat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni;
 - 1.3. për parandalimin e ndonjë rreziku serioz të sigurisë publike.
2. Transferimi apo zbulimi i të dhënave personale nga Kosova në shtetin e huaj si rezultat i ekzekutimit të një kërkesë në bazë të këtij ligji, duhet të jetë në përputhje të plotë me Ligjin mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 91
Kompetencat për aktet nënligjore

Ministria e Drejtësisë, mund të nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 92
Dispozitat kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të Ligjit mbi Gjykatat respektivisht Ligjit mbi Prokurorin e Shtetit, kompetenca e gjykatave respektivisht e prokurorive përkatëse do të rregullohet në bazë të atyre ligjeve.

2. Procedurat për ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare të filluara para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, por të cilat nuk kanë përfunduar deri në këtë datë , do të vazhdojnë dhe përfundohen në pajtim me dispozitat e Kapitullit XLVII dhe XLVIII të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 93
Dispozitat shfuqizuese

Dispozitat e Kapitullit XLVII dhe XLVIII të Kodit të Procedurës Penale do të pushojnë të jenë të aplikueshme për të gjitha lutjet për ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare të dërguara pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 94
Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-31
31 gusht 2011

Shpallur me dekretin Nr.DL-027-2011, datë 31.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.